

AmCham

INDEKSI i Biznesit 2014 - 2015



Prill 2015

Ferra Latte

.....i shëndetshëm si fëmija juaj



Floriol. Shija e jetës!



Floriol



“CILËSI E GARANTUAR”



IT OIL
INTERNATIONAL

LETËR NGA AMBASADORI AMERIKAN

Të nderuar anëtarë të Dhomës Amerikane të Tregtisë,

Transparenca është instrumenti i vetëm më i mirë për të përmirësuar klimën e biznesit.


Dëshiroj të përgëzoj Dhomën Amerikane të Tregtisë për botimin e Indeksit të Biznesit të AmCham (IBA) për të tretin vit radhazi, si dhe të falenderoj kompaninë Konsort për përpilimin e të dhënave të raportit. IBA po kthehet në një instrument me ndikim gjithnjë e më të madh për investitorët amerikanë dhe të huaj për të vlerësuar sfidat dhe mundësitë e të bërit biznes në Shqipëri. IBA i këtij viti është indeksi më i dobishëm që ka botuar AmCham-i. Me të dhëna në dispozicion për tre vite të njëpasnjëshme, ne jemi në gjendje të identifikojmë prirje të reja në komunitetin e biznesit dhe të krijojmë standarde për t'i krahasuar me vitet e mëparshme.

Ishte kënaqësi kur pashë vlerësimin e IBA-s, që lehtësia e të bërit biznes është rritur në 42.77 nga 40.21 me përmirësime në 16 nga 27 kategori. U inkurajova akoma më tepër kur anëtarët e AmCham-it besojnë që klima e biznesit do të vazhdojë të përmirësohet në vitin 2015.

IBA jo vetëm që luan rol kyç për të fokusuar prioritetet e AmCham-it, por edhe i ofron të dhëna objektive e të matshme qeverisë për të ndihmuar në formësimin e politikave të saj të biznesit dhe investimeve. Ndërkohë që qeveria kërkon të zhvillojë politika për nxitjen e investimeve në Shqipëri, ky dokument do të shërbejë si një përmbledhje e shkëlqyer e pritshmërive të komunitetit shqiptar të biznesit. Duke u konsultuar me IBA-n, qeveria do të jetë në gjendje t'i identifikojë e t'i rendisë këto përpjekje sipas rëndësisë.

Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë është krenare që mbështet AmCham-in dhe IBA-n dhe do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtësisht me anëtarët e saj për promovimin e interesave të komunitetit amerikan të biznesit në Shqipëri.

Sinqerisht,



Donald Lu

LETËR NGA PRESIDENTI I AMCHAM-IT

Të nderuar Anëtarë të AmCham,

Jam shumë i kënaqur t'ju prezantoj edicionin e tretë të Indeksit të Biznesit të AmCham, një instrument që ndihmon Dhomën Amerikane të Tregtisë në Shqipëri dhe anëtarët e saj, për të matur dhe për të krahasuar klimën e biznesit në vend gjatë viteve. Vitin e kaluar, AmCham-i pati mundësinë ta përdorë Indeksin për të pasuruar bazën e të dhënave të dobishme.


Indeksi i Biznesit të AmCham-it mat fushat më të rëndësishme të ekonomisë, që kanë prekur anëtarët tanë gjatë vitit kalendarik 2014. Anëtarët u janë përgjigjur pyetjeve të anketimit që kishin të bënin me riskun politik, politikat efikase fiskale, perceptimin e korrupsionit dhe ekonomisë informale, zbatimin e sundimit të ligjit, si dhe çështje të tjera të ekonomisë vendase. Ndërsa ka shumë fusha që janë të rëndësishme në një kuptim absolut, Indeksi i Biznesit të AmCham-it reflekton në mënyrë të veçantë pikërisht ato çështje që prekin më shumë anëtarët tanë.

Jam shumë i kënaqur me rezultatet e Indeksit, i cili nxjerr në pah sfidat me të cilat përballlet komuniteti i biznesit të AmCham-it, dhe në këtë mënyrë ndihmon leadershipin e AmCham-it se ku të përqendrohet në punën me qeverinë shqiptare dhe aktorët e tjerë për përmirësimin e mjedisit të biznesit në Shqipëri.

Indeksi i Biznesit të AmCham-it do të vazhdojë të botohet çdo vit, dhe gjetjet e tij do të ndahen me anëtarët e Dhomës Amerikane, qeverinë dhe institucione të tjera.

Unë do të doja të falënderoja në mënyrë të veçantë z. Benard Shehu dhe kompaninë e tij, KONSORT, për kontributin e tyre të anëtarësimit, për punën e vështirë dhe rezultatet e shkëlqyera, në përgatitjen e këtij Indeksi për Dhomën për të tretin vit radhazi.

Sinqerisht,



Mark Kroford

MIRËNJOHJE

Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri falenderon me mirënjohje Zëvendës-ambasadorin Amerikan në Tiranë, z. Henri Zhardin dhe ish Sekretarin e AmCham-it, z. Benard Shehu, CEO i kompanisë Konsort për propozimin e idesë dhe krijimin e Indeksit të Biznesit të AmCham-it.

Një falenderim me mirënjohje shkon edhe për Presidentin e Dhomës Amerikane, z. Mark Croford, për Bordin e Dhomës Amerikane, z. Genti Daci (Zëvendëspresident), z. Genci Likoskëndaj (Sekretar) znj. Alketa Uruçi (Përgjegjëse për thesarin), z. Aleksandër Sarapuli, z. Adrian Shehu, z. Avni Ponari, z. Elton Çollaku, znj. Julia Janecko, znj. Loreta Peçi, z. Peter Clavelle, si edhe për ish zëvendëspresidentin z. Arsen Kurti, ish përgjegjës për thesarin z. Steve Nutley dhe z. Donald Brown nga Ambasada Amerikane, të cilët e përfaqëuan dhe e mbështetën idenë e këtij projekti.

Një falenderim i veçantë shkon për ish Drejtorin Ekzekutiv znj. Floreta Luli-Faber, Drejtorin Ekzekutiv z. Lorenc Gjoni dhe stafin e AmCham-it për kontributin e tyre si në publikimin e pyetësorit dhe të raportit ashtu edhe për nxitjen e anëtarëve të AmCham-it për të marrë pjesë në këtë pyetësor; të gjithë konsulentëve, analizuesve të të dhënave dhe hartuesve të faqeve online, të cilët kontribuan në këtë projekt.

Së fundi, AmCham-i i dedikon një falenderim me mirënjohje të gjithë anëtarëve të Dhomës Amerikane, që morrën pjesë në pyetësorin e tretë të Indeksit të Biznesit të AmCham-it.

Faleminderit.

E DREJTA E AUTORIT

Jepet leje për të përdorur, kopjuar dhe shpërndarë pjesë të këtij raporti dhe pa asnjë pagesë, privilegj apo kërkesë zyrtare të dhënë, për sa kohë materiali përdoret me njohjen dhe atributin për Dhomën Amerikane të Tregtisë në Shqipëri.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
1 RRETH INDEKSIT TË BIZNESIT TË AMCHAM-it	7
2 PJESËMARRËSIT	8
2.1 Shkalla e Përgjigjeve	8
2.2 Profili i të Anketuarve	8
2.3 Profili i Kompanive Pjesëmarrëse	9
3 INDEKSI I BIZNESIT TË AMCHAM-it	11
3.1 Llogaritja e Indeksit	11
3.2 Rezultati i Indeksit të Biznesit të AmCham-it për vitin 2014	12
3.3 Rezultatet e pyetjeve individuale për vitin 2014 dhe 2015	14
3.4 Krahasimet e rezultateve të pyetjeve individuale ndërmjet vitit 2013 dhe 2014	15
4 REZULTATET E SONDAZHIT	16
4.1 KLIMA E PËRGJITHSHME E BIZNESIT	16
4.2 FAKTORËT E KLIMËS SË BIZNESIT	17
4.2.1 Niveli i Korrupsionit	18
4.2.2 Niveli i Burokracisë Qeveritare	19
4.2.3 Niveli i Ekonomisë Informale	20
4.2.4 Niveli i Konkurrencës së Pandershme dhe i Monopoleve	21
4.2.5 Rendi dhe Siguria në Vend	22
4.2.6 Klima e Brendshme Politike	23
4.2.7 Infrastruktura	24
4.2.8 Furnizimi me Energji	25
4.2.9 Pronësia Private	26
4.2.10 Pronësia Intelektuale	27
4.3 POLITIKA QEVERTARE	28
4.3.1 Marrëdhënia me Autoritetet Tatimore	29
4.3.2 Marrëdhënia me Autoritetet Doganore	30
4.3.3 Marrëdhënia me Ministrinë	31
4.3.4 Marrëdhënia me Qeverinë Lokale	32
4.3.5 Marrëdhënia me Gjykatën	33
4.3.6 Reformat Ekonomike dhe Politikat e Qeverisë	34
4.3.7 Niveli i Përgjithshëm i Taksave	35
4.3.8 Zbatimi i Ligjeve dhe i Rregulloreve	36
4.4 PERFORMANCA E EKONOMISË	37
4.5 AKTIVITETI I BIZNESIT	38
4.5.1 Kërkesa për Mallra dhe Shërbime	39
4.5.2 Kërkesa për Mallra dhe Shërbime – Eksportet	40
4.5.3 Ndryshimet në Punësim	41
4.5.4 Investimet e Kompanive	42
4.6 KLIMA FINANCIARE	43
4.6.1 Politikat dhe Shërbimet e Sektorit Bankar	43
4.6.2 Sigurimi i Fondeve Financiare	44
4.7 BURIMET NJERËZORE	45
4.7.1 Gjetja e Stafit të Kualifikuar Vendas	45
5 HARTA E TREGUESËVE TË INDEKSIT TË BIZNESIT TË AMCHAM-it	46
6 SHTOJCAT	47
SHTOJCA I: KOMENTET E TË ANKETUARVE	47
REKOMANDIME PËR QEVERTINË	47
KOMENTE PËR PYETJE SPECIFIKE	50
KOMENTE TË PËRGJITHSHME	52
SHTOJCA II: METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË INDEKSIT	53
PYETJE TË PËRFSHIRA NË INDEKS	53
FORMULA E LLOGARITJES	53
SHTOJCA III: BORDI DREJTUES I AMCHAM-it	54
SHTOJCA IV: ANËTARËT E AMCHAM-it	55

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Indeksi i Biznesit të AmCham-it 2014 është: **42.77** nga 100, me një tendencë në rritje për vitin 2015.

Krahasuar me vitin 2013, në vitin 2014 ka një përmirësim të klimës së biznesit. Megjithatë, 45% e anëtarëve të AmCham-it vazhdojnë ta shohin klimën e biznesit në Shqipëri në vitin 2014 si të pafavorshme ose shumë të pafavorshme. Pritshmëritë për klimën e biznesit për vitin 2015 (45.15) janë më të larta se në vitin 2014 (39.02).

Tre shqetësimet kryesore në vitin 2014 të raportuara nga të anketuarit, përfshijnë ekonominë informale (28.04), burokracinë qeveritare (31.31) dhe konkurrencën e pandershme ose monopolet (31.78).

Të anketuarit patën një perceptim pozitiv për faktorët si marrëdhënia me autoritetet doganore, qeverinë lokale, ministritë, autoritetet tatimore dhe gjykatat. Ndryshe nga faktorët e përmendur më lartë, perceptimi për treguesin “Niveli i Përgjithshëm i Taksave” ka rënë ndjeshëm gjatë vitit 2014.

Anëtarët e AmCham-it perceptuan një lëvizje pozitive të ekonomisë shqiptare në vitin 2014 (40.14) në krahasim me atë të vitit 2013 (30.21). Ata presin që kjo lëvizje pozitive do të vazhdojë gjatë vitit 2015 duke arritur 49.27. Veç kësaj, kërkesa për mallra dhe shërbime gjithashtu është përmirësuar në vitin 2014 dhe pritet të rritet në vitin 2015, ndërkohë që kërkesa për mallra dhe shërbime për eksport ka pasur një rënie të lehtë gjatë vitit 2014.

Pjesa më e madhe e anëtarëve të AmCham-it vazhduan të investonin në 2014-ën dhe kanë për qëllim të vazhdojnë këtë prirje edhe në vitin 2015. Pavarësisht nga vazhdueshmëria e investimeve, më shumë se 35% e anëtarëve të AmCham-it deklaruan se ka qenë ende e vështirë për të gjetur mundësi financimi për aktivitetin e tyre edhe pse ata besojnë se politika e bankave dhe shërbimet kishin një tendencë të favorshme në vitin 2014.

Indeksi i ndryshimit të punësimit ka pasur një rritje të lehtë në vitin 2014 dhe pritet të mbetet i qëndrueshëm në vitin 2015. Për shumicën e kompanive që janë përgjigjur, mundësia për të gjetur staf vendas të kualifikuar në 2014-ën vazhdon të mbetet e vështirë ose shumë e vështirë. Kjo prirje pritet të përmirësohet disi në vitin 2015.

Indeksi i Biznesit të AmCham-it (IBA) është indeks vjetor i krijuar nga Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri, në bashkëpunim me Konsort sh.p.k., i cili mat perceptimin e anëtarëve të AmCham-it për klimën e biznesit në Shqipëri.

Indeksi mat elementët e rëndësishëm si politikën e qeverisë, nivelin e taksave, korrupsionin, informalitetin, zbatimin e ligjit dhe gjithashtu elementë lidhur me performancën e bizneseve dhe ekonomisë shqiptare.

Ky indeks lejon AmCham-in të identifikojë dhe të masë problemet që has komuniteti i biznesit dhe i jep mundësinë Dhomës të punojë me qeverinë dhe aktorë të tjerë, për të përmirësuar klimën e biznesit në Shqipëri.

Indeksi dhe raporti i tij publikohen çdo vit dhe gjetjet e tij janë ndarë me anëtarët e AmCham-it, qeverinë dhe institucione të tjera. Indeksi i parë i Biznesit të AmCham-it u publikua në maj të vitit 2013 në bashkëpunim me Konsort.

Indeksi i Biznesit të AmCham-it ka tre përbërës kryesorë:

- **Sondazhin** e anëtarëve të AmCham-it, me pyetje lidhur me klimën e biznesit në Shqipëri.
- **Raportin**, i cili analizon dhe prezanton rezultatet e sondazhit.
- **Indeksin** në vetvete, i cili përfaqëson në një numër të vetëm perceptimin e anëtarëve të AmCham-it për klimën e biznesit në Shqipëri.

Indeksi i Biznesit të AmCham-it i vitit 2014-2015 u realizua *online* nga data 16 shkurt deri më 13 mars 2015, duke përdorur një platformë ndërkombëtare *online* (SurveyMonkey.com). Sondazhi, analiza e të dhënave dhe raporti u përgatit nga Konsort.

Sondazhi u drejtohej ekskluzivisht anëtarëve të AmCham-it dhe kërkonte mendimin e tyre lidhur me klimën e biznesit në Shqipëri për vitin e kaluar (2014) dhe vlerësimin e tyre për vitin aktual (2015).

Sondazhi kishte 45 pyetje të grupuara në seksione logjike. Të anketuarit mund të zgjidhnin të plotësonin pyetësonin në gjuhën shqipe ose në anglisht.

AmCham-i kërkoi që sondazhi të plotësohej nga Presidentët e Kompanive, Administratorët, CEO-t ose ekzekutivë të lartë.

Sondazhi ishte anonim dhe të dhënat e mbledhura nuk lejojnë identifikimin e përgjigjeve të anketuesve. Mbyllja e sondazhit dhe transferimi i të dhënave u realizua në prezencën e një Noteri Publik dhe një kopje e koduar e të dhënave anonime u depozitua tek Noteri Publik.

Sondazhi Indeksi i Biznesit të AmCham-it dhe raporti i tij janë aprovuar nga Bordi Drejtues i AmCham-it.


2.1 SHKALLA E PËRGJIGJEVE

Numri total i kompanive pjesëmarrëse në sondazh ishte 112 nga 220 anëtarë që ka AmCham-i. Nga 112 kompanitë pjesëmarrëse, 103 prej tyre e kishin plotësuar totalisht sondazhin, duke iu përgjigjur të gjitha pyetjeve.


Të gjitha përgjigjet e kompanive pjesëmarrëse janë përfshirë në rezultatet e sondazhit. Të gjithë grafikët paraqesin rezultatet në përqindje dhe të rrumbullakosur me një shifër pas presjes dhjetore. Përshkrimi në tekst është rrumbullakosur në numër të plotë.

2.2 PROFILI I TË ANKETUARVE

Pjesa më e madhe e të anketuarve në sondazh janë në pozicione të niveleve të larta në kompanitë e tyre duke përfshirë Presidentë, CEO, Administratorë ose Ekzekutivë të Lartë.




Rezultatet tregojnë se grupi më i madh i të anketuarve janë shqiptarët pasuar nga Amerika dhe vendet e BE-së.



2.3 PROFILI I KOMPANIVE PJESËMARRËSE


Pronësia e Kompanive

Grafiku në vijim tregon strukturën e pronësisë së kompanive që kanë marrë pjesë në sondazh. Më shumë se gjysma e kompanive që janë përgjigjur është në pronësi shqiptare.




Madhësia e Kompanive

Grafiku në vijim tregon madhësinë e kompanive pjesëmarrëse bazuar në numrin e tyre të të punësuarve dhe të ardhurat e gjeneruara për vitin 2014. Pjesa më e madhe e kompanive ka 10 deri në 50 të punësuar dhe kryesisht gjenerojnë deri në 1 milion dollarë amerikanë në të ardhura.




Të Ardhurat nga Eksportet

Rezultatet tregojnë se më shumë se një e treta e kompanive pjesëmarrëse kanë gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i eksportit. Pjesa tjetër ishte e fokusuar kryesisht në tregjet shqiptare.



Aktivitetet Kryesore të Kompanive

Në grafikun tjetër më poshtë tregohet aktiviteti kryesor i kompanive pjesëmarrëse në këtë sondazh.



Tjetër (Organizata Jo fitimprurëse, Shërbime Sigurie etj.)*

3

INDEKSI I BIZNESIT TË AMCHAM

3.1 LLOGARITJA E INDEKSIT

Indeksi i Biznesit të AmCham-it përfaqëson perceptimin e anëtarëve të AmCham-it për klimën e biznesit në Shqipëri. Ky indeks është llogaritur në bazë të grupit të pyetjeve të listuara në tabelën si më poshtë:


Tabela e Indeksit të Biznesit të AmCham-it	
<i>Pesha e Pyetjeve</i>	100%
Klima e Përgjithshme e Biznesit	25%
<i>Si ishte klima e biznesit në Shqipëri gjatë vitit të kaluar?</i>	25%
Faktorët e Klimës së biznesit	25%
<i>Ju lutem vlerësoni nivelin e faktorëve të mëposhtëm për vitin e kaluar në lidhje me aktivitetin e biznesit tuaj?</i>	
Niveli i Korrupsionit	2.5%
Burokracia Qeveritare	2.5%
Niveli i Ekonomisë Informale	2.5%
Konkurrenca e Pandershme dhe Monopolet	2.5%
<i>Ju lutem vlerësoni faktorët e mëposhtëm për vitin e kaluar në lidhje me aktivitetin e biznesit tuaj?</i>	
Rendi dhe Siguria në Vend	2.5%
Klima e Brendshme Politike	2.5%
Infrastruktura	2.5%
Furnizimi me Energji	2.5%
Pronësia Private	2.5%
Pronësia Intelektuale	2.5%
Politikat Qeveritare	20%
<i>Si ishte marrëdhënia mes biznesit tuaj dhe institucioneve publike të mëposhtme gjatë vitit të kaluar?</i>	
Marrëdhënia me Autoritetet Tatimore	1%
Marrëdhënia me Autoritetet Doganore	1%
Marrëdhënia me Ministrinë	1%
Marrëdhënia me Qeverinë Lokale	1%
Marrëdhënia me Gjykatat	1%
<i>Si i konsideroni reformat ekonomike dhe politikat e qeverisë gjatë vitit të kaluar për biznesin tuaj?</i>	4%
<i>Si e konsideroni nivelin e përgjithshëm të taksave gjatë vitit të kaluar për biznesin tuaj?</i>	5%
<i>Si e konsideroni zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve kundrejt biznesit tuaj gjatë vitit të kaluar?</i>	6%
Performanca e Ekonomisë	5%
<i>Si e konsideroni performancën e ekonomisë shqiptare gjatë vitit të kaluar?</i>	5%
Aktiviteti i Biznesit	15%
<i>Si ka qenë kërkesa për produktet dhe shërbimet e firmës tuaj gjatë vitit të kaluar?</i>	6%
<i>Si ka ndryshuar numri i të punësuarve në kompaninë tuaj gjatë vitit të kaluar?</i>	6%
<i>Si ka ndryshuar niveli i investimeve në kompaninë tuaj gjatë vitit të kaluar?</i>	3%
Klima Financiare	5%
<i>Sa e lehtë ishte për kompaninë tuaj të siguronte financim për zhvillimin e biznesit gjatë vitit të kaluar?</i>	5%
Burimet Njerëzore	5%
<i>Sa e lehtë ishte për kompaninë tuaj të gjente staf vendas të kualifikuar gjatë vitit të kaluar?</i>	5%

Çdo pyetje e përdorur për llogaritjen e indeksit ka një peshë, e cila është e bazuar në rëndësinë e saj relative mbi klimën e përgjithshme të biznesit në Shqipëri. Shuma e të gjitha rezultateve të këtyre pyetjeve është rezultati i Indeksit të Biznesit të AmCham-it.


Informacioni i detajuar lidhur me metodologjinë e llogaritjes së indeksit, mund të gjendet në **Shtojcën 1 të këtij dokumenti.*

3.2 REZULTATI I INDEKSIT TË BIZNESIT TË AMCHAM-IT PËR 2014

Rezultati për vitin 2014 i Indeksit të Biznesit të AmCham-it është **42.77** nga 100 me një tendencë në rritje për vitin 2015.



Grafiku i mëposhtëm tregon zhvillimin e Indeksit të Biznesit të AmCham-it gjatë vitit 2012-2014, përfshirë një projektim për vitin 2015. Rezultatet në rritje janë pozitive. Në përgjithësi, ka një trend në rritje të indeksit, duke arritur nivelet më të larta në parashikimet e vitit 2015.



3.3 REZULTATET E PYETJEVE INDIVIDUALE PËR VITIN 2014 DHE 2015

Tabela e mëposhtme tregon rezultatet e konsoliduara për çdo pyetje të sondazhit të Indeksit të Biznesit të AmCham-it. (Rezultati Minimal i mundshëm është 0 dhe rezultati maksimal i mundshëm është 100). Këto pyetje janë të renditura nga pyetja që ka marrë rezultatin më të ulët në pikë deri në pyetjen me rezultatin më të lartë.

Renditja	Pyetja (Version i Shkurtër)	Rezultatet 2014	Parashikimi për 2015 -ën	
1	Niveli i Ekonomisë Informale	28.04		
2	Burokracia Qeveritare	31.31		
3	Konkurrenca e Pandershme dhe Monopolet	31.78		
4	Niveli i Përgjithshëm i Taksave	34.13		
5	Gjetja e Stafit Vendas të Kualifikuar	35.34	36.65	▲
6	Niveli i Korrupsionit	36.92		
7	Klima e Brendshme Politike	38.79		
8	Klima e Biznesit	39.02	45.15	▲
9	Performanca e Ekonomisë Shqiptare	40.14	49.27	▲
10	Zbatimi i Ligjeve dhe Rregulloreve	40.38		
11	Sigurimi i Fondeve për Zhvillimin e Biznesit	41.35	43.45	▲
12	Reformat Ekonomike dhe Politikat e Qeverisë	41.83	49.03	▲
13	Rendi dhe Siguria në Vend	44.63		
14	Pronësia Intelektuale	45.09		
15	Politikat dhe Shërbimet e Sistemit Bankar**	48.56		
16	Pronësia Private	49.30		
17	Infrastruktura	50.00		
18	Kërkesa për Mallra dhe Shërbime	51.68	56.80	▲
19	Marrëdhënia me Gjykatat	51.68		
20	Kërkesa për Mallra dhe Shërbime për Eksportet**	53.68	53.75	▼
21	Ndryshimet në Punësim	53.85	53.16	▼
22	Ndryshimi i Investimeve	55.53	55.58	▼
23	Marrëdhënia me Autoritetet Tatimore	58.89		
24	Marrëdhënia me Qeverinë Lokale	59.13		
25	Marrëdhënia me Ministritë	59.86		
26	Furnizimi me Energji	61.45		
27	Marrëdhënia me Autoritetet Doganore	64.90		

*Informacioni i detajuar lidhur me llogaritjen e rezultateve, mund të gjendet në Shtojcën II të këtij dokumenti.

**Rezultatet e këtyre pyetjeve nuk janë të përfshira në llogaritjet e Indeksit të Biznesit të AmCham-it.

3.4 KRAHASIMI I REZULTATEVE PËR PYETJET INDIVIDUALE NDËRMJET VITIT 2013 DHE 2014

Tabela e mëposhtme tregon krahasimin e rezultateve të konsoliduara të sondazhit të Indeksit të Biznesit të AmCham-it ndërmjet vitit 2013 dhe 2014. Rezultatet janë të renditura bazuar në pikët e vitit 2013, duke filluar nga ata që kanë marrë pikët më të ulta deri tek ata me pikë më të larta.

Rend.	Pyetja (Version i Shkurtër)	Rezult. 2013	Rezult. 2014	Tendenca në 2014
1	Niveli i Ekonomisë Informale	24.09	28.04	▲
2	Burokracia Qeveritare	26.02	31.31	▲
3	Konkurrenca e Pandershme dhe Monopolet	29.85	31.78	▲
4	Performanca e Ekonomisë Shqiptare	30.21	40.14	▲
5	Niveli i Korrupsionit	30.87	36.92	▲
6	Klima e Brendshme Politike	33.16	38.79	▲
7	Klima e Biznesit	33.42	39.02	▲
8	Gjetja e Stafit Vendas të Kualifikuar	36.46	35.34	▼
9	Sigurimi i Fondeve për Zhvillimin e Biznesit	37.76	41.35	▲
10	Reformat Ekonomike dhe Politikat e Qeverisë	38.28	41.83	▲
11	Zbatimi i Ligjeve dhe Rregulloreve	41.41	40.38	▼
12	Infrastruktura	45.41	50.00	▲
13	Kërkesa për Mallra dhe Shërbime	45.57	51.68	▲
14	Politikat dhe Shërbimet e Sistemit Bankar**	45.83	48.56	▲
15	Pronësia Intelektuale	45.92	45.09	▼
16	Rendi dhe Siguria në Vend	45.92	44.63	▼
17	Niveli i Përgjithshëm i Taksave	49.48	34.13	▼
18	Pronësia Private	49.49	49.30	▼
19	Marrëdhënia me Gjykatat	51.04	51.68	▲
20	Ndryshimet në Punësim	51.56	53.85	▲
21	Ndryshimi i Investimeve	52.60	55.53	▲
22	Marrëdhënia me Autoritetet Tatimore	54.69	58.89	▲
23	Kërkesa për Mallra dhe Shërbime për Eksportet**	55.88	53.68	▼
24	Marrëdhënia me Ministritë	58.33	59.86	▲
25	Marrëdhënia me Qeverinë Lokale	59.11	59.13	▼
26	Marrëdhënia me Autoritetet Doganore	59.64	64.90	▲
27	Furnizimi me Energji	65.31	61.45	▼

4.1 KLIMA E PËRGJITHSHME E BIZNESIT



Ky seksion paraqet mendimin e anëtarëve të Dhomës Amerikane të Tregtisë lidhur me klimën e përgjithshme të biznesit në Shqipëri gjatë vitit 2014 dhe pritshmëritë e tyre për vitin 2015.

Më shumë se (44%) e të anketuarve e konsiderojnë klimën e biznesit në Shqipëri gjatë vitit 2014 si të pafavorshme ose shumë të pafavorshme, ndërsa 13.1% e konsiderojnë atë si pozitive. Përqindja e të anketuarve të cilët konsiderojnë se klima e biznesit në Shqipëri në vitin 2015 do të jetë e favorshme ose shumë e favorshme është rritur në 31%.

Klima e Biznesit në Shqipëri:

Si ishte klima e biznesit në Shqipëri gjatë vitit të kaluar (2014)?

Si e parashikoni klimën e biznesit në Shqipëri për vitin 2015?



Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.2 FAKTORËT E KLIMËS SË BIZNESIT

Ky seksion paraqet mendimin e anëtarëve të AmCham-it lidhur me faktorët që luajnë një rol të rëndësishëm në klimën e biznesit dhe aktivitetet e tyre.



Rezultatet tregojnë se pjesa më e madhe e të anketuarve mendojnë se ekonomia informale (74%), burokracia qeveritare (68%), konkurrenca e pandershme dhe monopolet (63%), dhe korrupsioni (53%), kanë qenë në nivele të larta ose shumë të larta gjatë vitit 2014.

Klima e brendshme politike ka patur një zhvillim nga viti 2013, megjithatë 49% e të anketuarve vazhdojnë të mendojnë se ajo ishte keq ose shumë keq gjatë vitit 2014.

Treguesi i Rendit dhe Sigurisë u ul në vitin 2014, ku 40% e të anketuarve e vlerësuan atë si të keq ose shumë të keq.



Të anketuarit raportuan se perceptimi i tyre lidhur me infrastrukturën u përmirësua në vitin 2014, ndërsa perceptimi i tyre për furnizimin me energji u ul.

4.2.1 NIVELI I KORRUPSIONIT





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.2.2 NIVELI I BUOKRACISË QEVERITARE





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.2.3 NIVELI I EKONOMISË INFORMALE





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.2.4 NIVELI I KONKURENCËS SË PANDERSHME DHE I MONOPOLEVE





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.2.5 RENDI DHE SIGURIA NË VEND





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.2.6 KLIMA E BRENDSHME POLITIKE





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.2.7 INFRASTRUKTURA





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.2.8 FURNIZIMI ME ENERGJI





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.2.9 PRONËSIA PRIVATE



Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.2.10 PRONËSIA INTELEKTUALE



Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.3 POLITIKAT QEVERITARE



Ky seksion paraqet mendimin e të anketuarve lidhur me ndikimin e politikave të qeverisë dhe marrëdhënien e anëtarëve të AmCham-it me institucionet e qeverisë lokale dhe qendrore.

Rezultatet tregojnë se 43% e anëtarëve të AmCham-it i perceptuan reformat ekonomike dhe politikat e qeverisë gjatë vitit 2014 si të pafavorshme, ndërsa 25% e tyre i perceptuan ato si të favorshme. Në lidhje me parashikimet për vitin 2015, 34% e të anketuarve presin që reformat ekonomike do të jenë të favorshme ose shumë të favorshme, ndërsa 32% e tyre presin që ato të jenë të pafavorshme ose shumë të pafavorshme.

Përafërsisht 56% e të anketuarve e konsiderojnë nivelin e përgjithshëm të taksave të aplikuara gjatë 2014-ës si të pafavorshëm ose shumë të pafavorshëm, ndërsa 36% e tyre e konsiderojnë atë neutral. Pjesa e mbetur 8% e konsiderojnë nivelin e taksave si të favorshëm ose shumë të favorshëm.



Vetëm 16.3% e të anketuarve e konsiderojnë aplikimin e ligjeve dhe rregulloreve në vitin 2014 si të favorshëm ose shumë të favorshëm. Pothuajse 41% e të anketuarve e konsiderojnë atë si të pafavorshëm ose shumë të pafavorshëm.

4.3.1 MARRËDHËNIA ME AUTORITETET TATIMORE





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.3.2 MARRËDHËNIA ME AUTORITETET DOGANORE





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.3.3 MARRËDHËNIA ME MINISTRITË





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.3.4 MARRËDHËNIA ME QEVERINË LOKALE



Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.3.5 MARRËDHËNIA ME GJYKATAT





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.3.6 REFORMAT EKONOMIKE DHE POLITIKAT E QEVERISË



Si i konsideroni reformat ekonomike dhe politikat e qeverisë gjatë vitit të kaluar (2014) për biznesin tuaj?

Si prisni të jenë reformat ekonomike dhe politikat e qeverisë për biznesin tuaj në vitin 2015?





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.3.7 NIVELI I PËRGJITHSHËM I TAKSAVE



Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.3.8 ZBATIMI I LIGJEVE DHE RREGULLOREVE



Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.



4.4 PERFORMANCA E EKONOMISË

Për 50% të anëtarëve të AmCham-it, performanca e ekonomisë shqiptare është ulur ose është ulur dukshëm gjatë vitit 2014. Megjithatë, 17% e tyre kanë raportuar se është rritur. Pritshmëritë për vitin 2015 tregojnë se 33% e anëtarëve të AmCham-it mendojnë se performanca e ekonomisë shqiptare do të rritet, ndërsa 30% mendojnë se ajo do të vazhdojë të ulet.

Performanca e Ekonomisë:

Si e konsideroni performancën e ekonomisë shqiptare gjatë vitit të kaluar (2014)?

Si e parashikoni performancën e ekonomisë shqiptare për vitin 2015?



Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.5 AKTIVITETI I BIZNESIT

Ky seksion analizon performancën e aktiviteteve të biznesit të anëtarëve të AmCham-it gjatë vitit 2014 dhe pritshmëritë e tyre për vitin 2015.

Kërkesa për mallra dhe shërbime në 2014-ën është rritur për 34% të të anketuarve. Për 42% të tyre ka mbetur e njëjtë, ndërkohë për 23% të tyre është ulur. Pritshmëritë për 2015-ën janë pozitive.

Kërkesa për mallra dhe shërbime për kompanitë eksportuese ka pasur një ulje të lehtë në vitin 2014 dhe pritjet të ketë një trend pozitiv përsëri gjatë vitit 2015.



Punësimi i përgjithshëm ka mbetur i njëjtë për 45% të kompanive gjatë 2014-ës, ndërsa rreth 34% e tyre kanë raportuar se e kanë rritur numrin e stafit. Për vitin 2015, më shumë se gjysma e tyre (52%) planifikojnë të mbajnë të njëjtin staf dhe 30% e tyre do ta rrisin ose do ta rrisin shumë nivelin e punësimit në kompanitë e tyre.

Në 2014-ën, rreth 42% e kompanive rritën investimet ndërsa 40% e tyre mbajtën të njëjtin nivel. Në 2015-ën, 44% e kompanive parashikojnë të rrisin investimet e tyre, ndërkohë që 39% do të mbajnë të njëjtin nivel investimesh si në 2014-ën.

4.5.1 KËRKESA PËR MALLRA DHE SHËRBIME

Si ka qenë kërkesa për produktet dhe shërbimet e firmës tuaj gjatë vitit të kaluar (2014)?

Si parashikoni të jetë kërkesa për produktet dhe shërbimet e kompanisë tuaj gjatë vitit 2015?





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.5.2 KËRKESA PËR MALLRA DHE SHËRBIME – EKSPORTET

Në rast se eksportoni, si ka qenë kërkesa për produktet dhe shërbimet e firmës tuaj gjatë vitit të kaluar (2014)?



Si parashikoni të jetë kërkesa e eksportit për produktet dhe shërbimet e kompanisë tuaj gjatë vitit 2015?



Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.5.3 NDRYSHIMET NË PUNËSIM

*Si ka ndryshuar numri i të punësuarve në kompaninë tuaj gjatë vitit të kaluar (2014)?
Si mendoni se do të ndryshojë numri i të punësuarve në kompaninë tuaj gjatë vitit 2015?*





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.5.4 INVESTIMET E KOMPANIVE

Si ka ndryshuar niveli i investimeve në kompaninë tuaj gjatë vitit të kaluar (2014)?

Si mendoni se do të jetë niveli i investimeve të kompanisë tuaj gjatë vitit 2015?





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.6 KLIMA FINANCIARE

Ky seksion paraqet mendimin e anëtarëve të AmCham-it lidhur me klimën financiare në Shqipëri, në termat e financimit të zhvillimit të biznesit dhe politikat e shërbimet që sistemi bankar ofron për kompanitë.

Për 38% të kompanive ishte e vështirë ose shumë e vështirë për të siguruar fonde për investimet për vitin 2014. Si pasojë, 32% e tyre presin që kjo situatë të vazhdojë edhe në vitin 2015.

4.6.1 POLITIKAT DHE SHËRBIMET E SEKTORIT BANKAR





Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

4.6.2 SIGURIMI I FONDEVE FINANCIARE

Sa e lehtë ishte për kompaninë tuaj të siguronte financim për zhvillimin e biznesit gjatë vitit të kaluar (2014)?

Si mendoni se do të jetë sigurimi i financimeve për zhvillimin e aktiviteteve të biznesit tuaj gjatë vitit 2015?



Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.



4.7 BURIMET NJERËZORE

Çështja e gjetjes së stafit vendas të kualifikuar vazhdon të mbetet problematike në vitin 2014. Për më shumë se 50% e të anketuarve, ishte akoma e vështirë ose shumë e vështirë për të gjetur staf të kualifikuar vendas për aktivitetet e tyre.

4.7.1 GJETJA E STAFIT VENDAS TË KUALIFIKUAR

Sa e lehtë ishte për kompaninë tuaj të gjente personel vendas të kualifikuar gjatë vitit të kaluar (2014)?


Si e mendoni gjetjen e stafit vendas të kualifikuar në vitin 2015?



Kjo tabelë paraqet treguesin e zhvillimit. Rezultatet në rritje janë pozitive.

5 HARTA E TREGUESIT TË INDEKSIT TË BIZNESIT TË AMCHAM-IT

Grafiku i mëposhtëm paraqet situatën e përgjithshme të klimës së biznesit dhe Indeksit të Biznesit të AmCham-it për vitin 2014. Madhësia e drejtkëndëshit / tabelës tregon impaktin që ka treguesi në Indeksin e Biznesit të AmCham-it. Ngjyra e drejtkëndëshit tregon rezultatin dhe situatën e treguesit në vitin 2014.



6 SHTOJCAT

SHTOJCA I: KOMENTET E TË ANKETUARVE

Të gjitha komentet e bëra nga pjesëmarrësit janë të paraqitura në këtë seksion.

REKOMANDIME PËR QEVERINË

Pyetja: Sipas mendimit tuaj, cilat janë masat që duhet të merren nga qeveria shqiptare për të përmirësuar klimën e biznesit në Shqipëri?

Komenti 1 (I përkthyer): Konsistenca; Parashikueshmëria; Transparenca;

Komenti 2 (I përkthyer): Përmirësimin e sigurisë publike; Masat kundër informalitetit dhe evazionit fiskal; Përmirësim në furnizim të vazhdueshëm me energji; Mbështetje për çdo punonjës të ri të punësuar; Rritjen e granteve për bizneset e konsoliduara;

Komenti 3 (I përkthyer): 1. Të fillojë të punojë mbi Rregulloret e Informalitetit, Task Forcës dhe Zbatimin / Ndjekjen. 2. Për të nisur formalizimin e entiteteve të biznesit të vogël. 3. Për të filluar përmirësimin e rezultateve të Drejtorisë së Autoritetit Tatimor: Vlerësimet e punës së punonjësve, performancën e punës së punonjësve, trajnimi i këtyre njerëzve (Biznesi dhe Sjellja).

Komenti 4 (I përkthyer): 1. Taksa më të ulëta për klasën e mesme dhe taksa më të larta për ato që marrin të ardhura nga burime të shumta. 2. Përmirësimi i performancës së autoriteteve tatimore dhe doganore në mbledhjen e të ardhurave jo duke shtuar gjokat e padrejta, por duke rritur transparencën në raportimin dhe kontrollin. Të trajnojnë stafin që të ketë sjellje më etike dhe profesionale dhe gjithashtu të prodhojnë një skemë monitorimi për vlerësimin e risqeve për tatimet dhe doganat që është i përshtatshëm me kompanitë dhe klimën e biznesit në Shqipëri. 3. Përdorimi i palëve të treta për të vlerësuar dhe monitoruar korrupsionin dhe trajtimet e padrejta në Shqipëri.

Komenti 5 (I përkthyer): Shqipëria i ka të gjitha ligjet e nevojshme dhe institucionet shtetërore, vetëm duhet t'i respektojnë ato dhe të këmbëngulin në zbatimin e sistemit elektronik kudo, në mënyrë që të shmangen të gjitha presionet artificiale të krijuara nga inspektorët që trokasin në dyert e biznesit çdo javë.

Komenti 6 (I përkthyer): De fakto dhe de juro për të zbatuar legjislacionin e BE-së dhe për të anuluar ligjin e ndalimit të mbeturinave (VKM).

Komenti 7 (I përkthyer): Të luftojë korrupsionin, taksa më të ulta, të luftojë krimin dhe më pak shërbime me burokraci etj.

Komenti 8 (I përkthyer): Të luftojë kundër korrupsionit dhe mos të rrisë taksat.

Komenti 9 (I përkthyer): Në mënyrë që të përmirësojmë klimën e biznesit çështja kryesore është e lidhur me dialogun politik. Do të ishte e nevojshme që të ketë transparencë dhe të udhëhiqet përmes likuiditetit të reformave të tregut. Kjo do të ndihmojë për investime dhe rritjen e kërkesës së konsumatorëve.

Komenti 10 (I përkthyer): Nuk ka kuptim që të taten jo fitimprurësit.

Komenti 11 (I përkthyer): Drejtësia dhe zbatimi i vendimit gjyqësor në kohë dhe me integritet. Transparenca për ndëshkimin e korrupsionit dhe procesin e duhur të paraqitjes së rasteve të korrupsionit.

Komenti 12 (I përkthyer): Taksa më të ulta, të luftojë korrupsionin dhe të mos ketë administratë politike.

Komenti 13 (I përkthyer): Masa për të ndihmuar në rritjen bizneseve dhe të ekonomisë. Administrata shtetërore duhet të ndryshojë mentalitetin e tyre: 1. Të kuptojnë se ata duhet të jenë në shërbim të qytetarëve të saj dhe kjo kërkon përmirësimin e cilësisë së shërbimit të tyre, 2. Të trajtojnë biznesin si një faktor të rëndësishëm për të mbajtur ekonominë në

rritje (dhe jo si një burim të përkohshëm likuiditeti, i cili nuk zgjat shumë dhe është në përgjithësi shumë i dëmshëm). Administrata shtetërore duhet t'i kushtojë vëmendje investitorëve të huaj dhe t'i trajtojë ata në mënyrë të drejtë dhe me respekt. Një investitor i huaj i pakënaqur, apo edhe një investitor i huaj i kënaqur duhet të jetë një çështje shumë shqetësuese për shtetin.

Komenti 14 (I përkthyer): Duhet të merren masa në: reformat në drejtësi, besimin në drejtësi dhe trajtimin në mënyrë të barabartë të çështjeve.

Komenti 15 (I përkthyer): Zgjidhje për problemet me pronën private (pronësinë, legalizimin dhe zvogëlimin e burokracisë).

Komenti 16 (I përkthyer): Nxitja e sigurisë ligjore dhe krijimi i stimujve të taksave.

Komenti 17 (I përkthyer): Të respektojnë sundimin e ligjit dhe për ta zbatuar atë REALISHT. Të respektojnë Administratën shtetërore dhe procedurat e saj. Të krijojnë vizionin dhe strategjitë e tyre për zhvillimin e vendit duke e DËGJUAR REALISHT komunitetin e biznesit dhe jo duke i injoruar ata. Të bëjnë reforma serioze në sistemin gjyqësor dhe ta luftojnë korrupsionin ME TË VËRTETË. Të bëjnë investime REALE në sistemin arsimor dhe të rrisin buxhetimit për universitetet publike me të pakten 8-10% të buxhetit total (sot është vetëm 3%). Shumica e problemeve me të cilat po përballet ky vend lidhen ngushtë me nivelin e ulët në arsim të njerëzve.

Komenti 18 (I përkthyer): Qeveria shqiptare ka nevojë të luftojë korrupsionin, të përdorë meritokracinë në punësim dhe jo interesin personal. Ata duhet të ndihmojnë biznesin e huaj që të operojë normalisht në Shqipëri dhe jo të rrisë barrierat për ta penguar me qëllim atë.

Komenti 19 (I përkthyer): Konsultimet me palët e interesuara duhet të jenë në një format dialogu. Qeveria vetëm mbledh sugjerimet nga palët e interesuara, por nuk zbaton asnjërin prej tyre. Diskutimi është një i vetëm dhe jo në dy mënyra. Ne nuk shohim ndonjë një strategji të qartë nga qeveria, se si duhet trajtuar rritja ekonomike, zhvillimi i turizmit dhe bujqësia si edhe disa zona të tjera strategjike të tilla si shëndetësia dhe arsimiti.

Komenti 20 (I përkthyer): Polarizimi politik vazhdon të ketë një ndikim negativ në klimën e biznesit. Partitë politike duhet: të gjejnë vend të përbashkët, ti japin fund sulmeve personale dhe të angazhohen në një dialog civil në çështjet e politikës. Çështjet që lidhen me pronën private duhet të zgjidhen. Dështimi për të adresuar çështjet e pronës do të vazhdojë të dekurajojë investimet e huaja dhe zhvillimin ekonomik. Pasiguritë relative për lëshimin e lejeve të planifikuar dhe të zhvilluar duhet të adresohen. Qeveria duhet ta bëjë përgatitjen e një Plani Kombëtar të Territorit një prioritet. Lëshimi i lejeve duhet të jetë qartësisht një përgjegjësi e deleguar e autoriteteve vendore me monitorimin e duhur të qeverisë qendrore dhe mbikëqyrjes.

Komenti 21 (I përkthyer): Të përmirësojë klimën e turizmit dhe të tërheqë investitorë dhe fonde.

Komenti 22: 1. Politika nxitëse për afrimin e investitorëve të huaj. 2. Uljen e informalitetit duke rritur kontrollin dhe efektshmërinë e tyre. 3. Përfshirjen e biznesit në hartimin e politikave të zhvillimit ekonomik. 4. Ngritjen e tregut të kapitaleve në mënyrë që kërkesa dhe oferta për kapitale të takohen në një treg të përbashkët (zhvillimi i bursës). 5. Amnisti e plotë deri në fund të 2014-ës dhe masa më të rrepta për 2015-ën e në vijim. Asnjëherë nuk është realizuar amnisti e plotë.

Komenti 23: 1. Të rrisë parashikueshmërinë e sistemit fiskal, duke rritur transparencën e nismave ligjore në këtë drejtim dhe konsultimin e gjerë me grupet e interesit. 2. Të zbatojë reforma fiskale më të favorshme për biznesin, duke krijuar incentiva për thithjen e investimeve të reja dhe hapjen e vendeve të reja të punës. 3. Të nxisë reformat kundër informalitetit, si p.sh. heqja e pragut të TVSH-së, reduktimi i progresivitetit të taksës mbi pagat, vendosja e tatimit progresiv mbi fitimin (përfshirë bizneset e vogla).

Komenti 24: 1. Eliminimi i informalitetit në të gjitha segmentet e ekonomisë dhe biznesit. 2. Masa rigorozë kundër korrupsionit. 3. Respektimi i të drejtave të autorit edhe nga Institucionet qeveritare.

Komenti 25: 1. Rikthimi tek tatimi për të ardhurat 10%. 2. Aplikimi i politikave nxitëse për investimet e huaja. 3. Reduktimi i korrupsionit, paaftësisë dhe burokracisë në institucionet shtetërore.

Komenti 26: 1. Të shtojë investimet publike sektoriale. 2. Të mos ndërhyjë në procesin e prokurimeve publike, por të monitorojë procesin nga pikëpamja e zbatimit të ligjit.

Komenti 27: 1. Qeveria duhet të luftojë ekonominë informale, duke rritur kështu bazën e taksapaguesve, vendosjen e rregullave të lojës për të gjithë operatorët ekonomikë. 2. Qeveria duhet të tregohet fleksibël me llojet e taksave që ka vendosur dhe me mënyrën se si i mbledh ato, ajo duhet të tjetërsojë taksat që realisht nuk arrin t'i mbledhë, apo i mbledh me performancë shumë të ulët dhe që i kërkojnë angazhim të madh, duke i shndërruar në taksa që janë me gjithëpërfshirëse (nënkupto pagesit) dhe që kërkojnë angazhim më të vogël njerëzor. Angazhim më shumë i zgjidhjeve teknologjike, apo stimuluere për konsumatorët që do të rezultojnë në përmirësimin e monitorimit real të operatorëve ekonomikë. 3. Liberalizimin real të tregut të furnizimit me energji elektrike, për të patur çmim dhe parametra teknike në nivel konkurrues me rajonin. 4. Ndihet nevoja për një ent rregullator, që të vendosë balanca reale tregu ndërmjet sistemit bankar dhe bizneseve në tërësi, Banka e Shqipërisë këtë rol e luan të njëanshëm vetëm në interes të bankave të nivelit të dytë. Kjo masë do të bënte që ekonomia, veçanërisht ajo prodhuese dhe eksportuese të përdornin paranë me kosto më të ulët.

Komenti 28: Burokracinë.

Komenti 29: Duhet ta shikojë taksapaguesin si njeri të çmuar.

Komenti 30: Duhet të përmirsohet klima mes Administratës Tatimore dhe biznesit.

Komenti 31: Duhet urgjent barazia dhe konkurrenca në treg që nga prokurimi fals elektronik, të bëhen urgjent 10% taksat, duhet të ulët energjia, duhet urgjent që pensionistët në ligjin e sigurimeve të mos trajtohen me pagë bazë 22 mijë lekë por me orë pune, duhet urgjent që dogana të ulët referencat, duhet urgjent që të marrin vlerë faturat dhe të njihet kuponi tatimor sepse vazhdon fiktiv shitblerja, të ulët në 10% taksa e qerasë e cila ka shkuar 15%, duhet që sigurimet shoqërore të bëhen 10% pasi ka filluar kursimi dhe nuk ka konsum, korrupsioni dhe pabarazia në treg na dëmton, shkurt duhet më shumë liri ekonomike.

Komenti 32: Jemi dakord që qeveria të bëjë të gjitha përpjekjet për të formalizuar ekonominë. Vetëm kjo do ta fusë vendin në rrugën e ligjit dhe ekonomia megjithëse me dhimbje në fillim, do të fillojë rritjen.

Komenti 33: Lidhur me tregun e automjeteve, që është një potencial i konsiderueshëm për ekonominë e të gjitha vendeve, është tepër emergjente dhe e domosdoshme që të vendosen standardet europiane të emetimit të gazrave dhe cilësisë, së paku 5 Euro, të përafrohet tregu me rregullat e rajonit, të vendosen kufizime serioze për importin e makinave të përdorura si në çdo vend, si për vitin e prodhimit ashtu edhe për normën e emetimit të gazrave. Si vend që tentojmë të zhvillojmë turizmin do të ishte më mirë të ndërpritej plotësisht importi i makinave të përdorura për qëllime tregtimi për një farë kohe, pasi tregu tashmë është i tejngopur me të tilla dhe ndotja që vjen për shkak të tyre është kërcënuese. Të vendoset nën kontroll të rreptë fiskal tregtimi i makinave të përdorura. Aktualisht, informaliteti në këtë biznes është 95%. Me gjithë kërkesat dhe ndërhyrjet tona pranë qeverisë dhe së fundmi edhe pranë organizmave ndërkombëtare në vend, nuk kemi asnjë reagim pozitiv. Vendosja e rregullit në këtë biznes do të jetë një burim i konsiderueshëm të ardhurash për vendin (nga parashikimi ynë, të ardhurat në buxhet do të rriteshin me rreth 150 milion euro çdo vit), mbrojtjen e mjedisit, sigurinë në rrugë dhe normalizimin e klimës së punës në këtë sektor.

Komenti 34: Mendoj që duhet të ketë më shumë frymë bashkëpunimi midis biznesit dhe qeverisë në mënyrë që biznesi të mos jetë gjithmonë nën presionin e organeve tatimore ose doganore.

Komenti 35: Në çdo pozicion shtetëror mos të ndihemi si biznese që po hajmë në kurriz të popullit dhe shtetit por si biznese që po mbajmë shtetin me taksa dhe me të punësuar. Qeveria duhet të konsultohet më shpesh me palët e interesit për ndryshimin e legjislacioneve

sipas fushave dhe të bëjë ndryshimet konfort legjislativ të BE-së dhe jo ligje që na vënë në vështirësi komunikimi me partnerët tanë, qofshin BE ose SHBA.

Komenti 36: Për të përmirësuar klimën e biznesit, duhet të ulë tatimin për biznesin e vogël dhe atë të madh, të ulë tatimfitimin nga 15% në 10%, të mbështesë me kredi afatgjata me inteteres të ulët bizneset etj.

Komenti 37: Përmirësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e markave të regjistruara dhe zbatimi rigoroz i tyre. Eliminimi i konkurrencës së pandershme dhe informalitetit. Kontroll më i rreptë nga institucionet tatimore dhe doganore mbi importet dhe evazionin fiskal.

Komenti 38: Qeveria duhet urgjent të lejojë ndërtimin, të punojë e thënë ndryshe, të japë leje për ndërtim, së dyti të rrisë efikasitetin e administratës shtetërore në marrëdhënie me biznesin, të luftojë informalitetin etj.

Komenti 39: Sikurse theksuam, duhet të luftohet informaliteti. Nuk deklarohen punimet, nuk deklarohen shitjet, ka fiktivitet. Nuk deklarohen punonjësit, nuk deklarohen pagat reale. Prona private e subjekteve private, administrohet si pronë personale e pronarëve, jo në bazë të ligjeve të shtetit.

Komenti 40: Të jetë e vendosur në luftën kundër ekonomisë informale në tregun e shitjeve me pakicë.

Komenti 41: Të jetë më e vëmendshme ndaj rekomandimeve të biznesit.

Komenti 42: Të kërkojë zbatimin e ligjeve me rigorozitet, por pa dallime klienteliste, në mënyrë që ta ndiejnë të gjithë forcën e ligjit dhe barazinë përpara ligjit.

Komenti 43: Të luftohet informaliteti. Përdorimi i kasave fiskale etj. Të reformohen organet tatimore dhe të përzgjidhet staf më i kualifikuar.

Komenti 44: Të nxisë biznesin të investojë duke thjeshtuar procedurat dhe burokracitë. Të shmangë kontrollin e shpeshta dhe bezdisëse nëpërmjet vizitave në ambjentet e punës dhe të nxisë shërbimet dixhitale për biznesin. Të luftojë informalitetin e lartë dhe të hartojë dhe zbatojë me rigorozitet ligje e rregullore të thjeshta.

Komenti 45: Të punohet më shumë për uljen e informalitetit.

Komenti 46: Të rregullohet problemi i pronës, të ulet akoma më shumë informalitetin, të ulen taksat për biznesin, të shtojë investimet publike, të ulë akoma më shumë burokracinë, të rrisë efikasitetin në administratën publike, të zhvillojë kapacitetet në administratë, t'i përgjigjet tregut, të investojë më shumë në arsim dhe kryesisht në arsimin profesional, të rrisë investimet e huaja duke nxitur bizneset e reja dhe duke nxitur investimet e huaja në sektorët strategjikë.

Komenti 47: Të rrisë konkurrencën e ndershme duke krijuar kushte të barabarta për biznese të të njëjtës fushë. Krijimi i mundësive për të zhbllokuar monopolet si mundësi për hapësira të reja punësimi.

Komenti 48: Të rrisë limitin e xhiros për biznesin e vogël nga 8,000,000 në 16,000,000. Ka shumë kohë që nuk ka ndryshuar dhe as norma e inflacionit nuk është marrë parasysh.

Komenti 49: Të ulë taksat.

Komenti 50: Të ulen nivelin e tatimfitimit dhe i të ardhurave personale pasi jemi vendi me nivelin më të lartë në rajon. Stabilizimi dhe konsolidimi i legjislativit tatimor, duke mos u ndryshuar disa herë brenda periudhës tatimore.

Komenti 51: Të vijojë me krijimin e lehtësirave në zyrat doganore e tatimore. Të shikojë mirë sistemin e taksimit pasi nuk është i favorshëm për biznesin.

Komenti 52: Të zbatojë konkurrueshmërinë dhe ndershëmërinë në treg njësoj për të gjitha bizneset, të rrisë shërbimet ndaj biznesit dhe shtrirjen e mirëmbajtjen e linjave të sistemit të furnizimit me energji elektrike, të përmirësojë rrjetin rrugor ndërqytetas.

Komenti 53: Të zvogëlojë informalitetin.

Komenti 54: Ulje të taksave për biznesin. Strategji për uljen e informalitetit në vend.

KOMENTE PËR PYETJE SPECIFIKE

Komentet e mëposhtme janë bërë nga të anketuarit për ndikimin e faktorëve si: Niveli i Korrupsionit, Niveli i Burokracisë Qeveritare, Niveli i Ekonomisë Informale, Konkurrenca e Pandershme dhe Monopolet, si dhe Marrëdhëniet me Autoritetet Qeveritare.

Komenti 1 (I përkthyer): Furnizimi me energji mbetet një pengesë e madhe. Shumë ndërprerje dhe orë pa energji elektrike. Kjo do të thotë kosto shtesë me gjeneratorë.

Komenti 2 (I përkthyer): Qeveria dështoi për të luftuar siç duhet evazionin fiskal dhe zgjodhi të marrë rrugën e lindjes duke ngritur taksat për investimet e huaja të cilët deklarojnë 100%. Qeveria dështoi në rregullimin e tregut dhe imponoi duke luajtur me sundimin e ligjit dhe tregut.

Komenti 3 (I përkthyer): Mungesa e ligjeve të sakta dhe të ekzekutimit të tyre.

Komenti 4 (I përkthyer): Konkurrenca e padrejtë mbetet si një barrë e madhe për biznesin.

Komenti 5 (I përkthyer): Kuadër rregullator të pafavorshëm dhe të padrejtë.

Komenti 6 (I përkthyer): Ne përballemi me pengesë në çdo proces duke filluar nga ato rregullatore deri në aprovimet e çmimeve.

Komenti 7 (I përkthyer): Ne shohim që krimi është rritur dhe shumë prej dyqaneve tona janë grabitur nga banditë të armatosur në mes të ditës në orët punës së biznesit. Kjo qeveri dështoi tërësisht në mbrojtjen e pronësisë intelektuale ndërkohë që, ligji i ri i premtuar mbi IPR-in nuk është miratuar ende. Shumë keq.

Komenti 8: Ekonomia informale në rritje, tregu financiar në gjendje oligopoli (janë vetëm bankat e nivelit të dytë dhe asnjë instrument tjetër alternativ), tregu i furnizimit me energji elektrike me kosto të lartë nga rajoni me çmim dhe cilësi shumë të ulët me parametrat teknik.

Komenti 9: Është e kotë të flasësh, prokurimet online janë vetëm me militantë partie dhe korrupsion totalisht. Ankohen drejtorët se nuk fitojnë dot nga blerjet online deri në 10.000 lekë dhe është bërë blerje e vogël mijë lekë dhe blerje me lekë në dorë deri në 12.000 lekë, kjo e ka këputur biznesin e madh dhe distributorët, pasi një të rënë të lapsit drejtori dhe 96.000 mijë direkt i blen ose nuk i blen materialet.

Komenti 10: Informaliteti është gangrena e biznesit në Shqipëri. Autoritetet nuk duan ta shohin fenomenin, i cili deformon tregun dhe shmang të ardhurat në buxhet.

Komenti 11: Mosmarrja parasysh e komenteve dhe shqetësimeve të operatorëve ekonomikë, të cilët duhet të konsiderohen si partnerë të qeverisë, në vendimet dhe politikat që ndikojnë rrjedhën e përditshme të biznesit.

Komenti 12: Në zonën ku ne punojmë (Vorë, pak km. nga aeroporti i Rinasit), furnizimi me energji elektrike prej 22 vjetësh është shumë keq. Ndërpritet pothuajse çdo ditë pa lajmërim dhe për kohë të gjatë punojmë kryesisht me gjenerator. Furnizimi me energji të pandërprerë është privilegj për kompanitë pranë pushtetit. Po kështu, nga pushteti vendor refuzohet të furnizohemi me ujë të rrjedhshëm. Aktualisht përdorim ujë pusi. Asnjë mbështetje nga pushteti vendor megjithëse jemi taksapagues VIP dhe vetëm taksa vendore në bashkinë e Vorës paguajmë çdo vit rreth 1.100.000 lek të reja. etj.etj.etj.

Komenti 13: Nga ta zesh e nga ta lesh, nga energjia që ikën pa lajmërim apo nga siguria, ku frika na ka bërë të vendosim kamera dhe roje ditë e natë, apo nga politika që jemi demokratë dhe dele e zezë me shumë kontrole dhe taksa etj.

Komenti 14: Pothuajse nuk mund të marrim pjesë në asnjë tender pasi fituesit janë të paracaktuar pavarësisht nga çmimi që ofrojnë dhe standardi i produktit që ofrojnë. Nuk ka asnjë standard për makinat që vijnë nga importi. Kërkohet prej nesh që të vendoset standardi 5 Euro (në Europë tashmë po fillon 6Euro) por refuzohet me këmbëngulje nga

qeveria. Nuk ka asnjë kufizim doganor, kohor, standard emetimi gazrash, ndotje etj. për makinat e përdorura. Informaliteti në tregtimin e tyre është galopant.

Komenti 15: P.Sh. Ligji i blerjeve të vogla ka shumë mangësi, lë shumë hapësira për abuzime nga ana e titullarëve të institucioneve.

Komenti 16: Tenderat janë në dorë të 2-3 kompanive.

Komenti 17: Vazhdojnë të hyjnë marka pa dokumenta dhe kjo ndikon në çmimet e tyre. affects the brand prices.

KOMENTE TË PËRGJITHSHME

Komentet e mëposhtme janë komente të përgjithshme të bëra nga pjesëmarrësit në fund të sondazhit.

Pyetja: A keni ndonjë koment shtesë?

Komenti 1 (I përkthyer): Dhoma Amerikane duhet të jetë më e drejtpërdrejtë në komunikimin me publikun në lidhje me vështirësitë që biznesi është duke u përballur.

Komenti 2 (I përkthyer): Ju jeni duke bërë një punë shumë të mirë me këtë sondazh dhe shpresoj se ju nuk do të mbani anë politike tek rezultatet, por do të pasqyroni realitetin. Më shumë se 45,000 njerëz që kanë emigruar nga ky vend gjatë vitit 2014, tregojnë qartë se ata nuk shohin asnjë shpresë për të ardhmen e këtij vendi.

Komenti 3: Administrata tatimore, doganore dhe inspektoratet, duhet të punojnë si shërbëtorë të shtetit dhe sipërmarrjes, jo të korruptohen dhe të mbyllin sytë përpara shkeljes së ligjeve e rregullave.

Komenti 4: AmCham-i të jetë akoma më aktiv në marrëdhënie me anëtarët dhe të advokojë akoma më fortë për problemet reale që shqetësojnë anëtarët dhe industri të caktuara.

Komenti 5: Ministrat dhe deputetët nuk të ngrenë telefonat.

Komenti 6: Qeveria duhet të jetë konsistente në plotësimin e kuadrit ligjor për biznesin si në ato të vendeve të zhvilluara dhe të BE-së dhe mos të ndikohet nga presione të grupeve apo pseudo shoqërisë civile që bëjnë lobim për interesa të çastit. Prioritet duhet të mbetet gjithmonë zbatimi i ligjit dhe plotësimi i standardeve për zhvillim të qëndrueshëm.

Komenti 7: Të hiqen/ulen taksat për sektorë strategjikë si p.sh. shërbimet e IT-së. Të mos varet rimbursimi i TVSH-së nga eksporti, sidomos nga eksporti i shërbimeve. Ne jemi kompani që eksportojmë shërbime IT-je dhe penalizohemi në TVSH-në e blerjes, si edhe në kohë menaxhimi për llogaritje të kësaj TVSH-je. Është jo logjike.

Komenti 8: Të përmirësohen shumë ligje që përkeqësojnë klimën e biznesit.

SHTOJCA II: METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË INDEKSIT

PYETJE TE PËRFSHIRA NË SHTOJCË

Indeksi i Biznesit të AmCham-it është llogaritur në bazë të rezultateve të pyetjeve të Indeksit të Biznesit të AmCham-it që gjenden në faqen 11 të këtij raporti.

Këto pyetje kanë pesë mundësi përgjigjeje, duke filluar nga përgjigjet negative (me 0 pikë) e deri tek përgjigjet shumë pozitive (me 100 pikë).

Për shembull pyetja “Si ishte klima e biznesit në Shqipëri vitin e fundit (2014)?” Pikët për secilën alternative janë:

Shumë e Pafavorshme	0
E Pafavorshme	25
Neutrale	50
E Favorshme	75
Shumë e Favorshme	100

Çdo pyetje e përdorur për llogaritjen e indeksit ka një peshë e cila është e bazuar në rëndësinë e saj relative mbi klimën e përgjithshme të biznesit në Shqipëri. Për shembull pyetja “Si e konsideroni performancën e ekonomisë shqiptare në vitin e kaluar?” ka një peshë prej 5% të totalit të indeksit.

Shuma e të gjitha rezultateve të peshuara është rezultati përfundimtar i Indeksit të Biznesit të AmCham-it.

FORMULA E LLOGARITJES

Së pari është llogaritur mesatarja e pikëve e secilës pyetje të përfshirë në llogaritjen e indeksit, duke përdorur formulën si më poshtë:

$$\bar{q} = \sum_{i=1}^n x_i / n$$

Ku: \bar{q} është rezultati mesatar i secilës pyetje

x_i është rezultati i çdo përgjigjeje të dhënë për pyetjen

$\sum x$ është shuma e pikëve të dhëna për pyetjen

n është numri i të anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes

Më pas, Indeksi i Biznesit të AmCham-it është llogaritur në bazë të peshës mesatare të pikëve të pyetjeve, duke përdorur formulën si më poshtë:

$$ABI = \sum_{i=1}^n (\bar{q}_i \times w_i)$$

Ku: **IBA** është Indeksi i Biznesit të AmCham-it

\bar{q}_i është mesatarja e pikëve për secilën pyetje të llogaritur më parë

w_i është pesha e ndarë për secilën pyetje

n është numri i pyetjeve të përfshira në llogaritjen e indeksit

SHTOJCA III: BORDI DREJTUES I AMCHAM-IT



Mark Crawford
President
Aksioner International Securities Brokerage



Genti Daci
Zëvendëspresident
ABCom



Genci Likoskëndaj
Sekretar
CCS Computer & Copier Systems



Alketa Uruçi
Përgjegjëse për Thesarin
BOGA & Associates



Adrian Shehu
Anëtar Bordi
T.C.N.



Aleksandër Sarapuli
Anëtar Bordi
Albanian - American Enterprise Fund



Avni Ponari
Anëtar Bordi
SIGAL Uniqa Group Austria



Elton Çollaku
Anëtar Bordi
Financial Union Tirana - Western Union



Julia Janecko
Anëtare Bordi
Abraham Lincoln Foundation of Albania



Loreta Peçi
Anëtare Bordi
PricewaterhouseCoopers Audit



Peter Clavelle
Anëtar Bordi
Tetra Tech ARD



Lorenc Gjoni
Drejtor Ekzekutiv
Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri

SHTOJCA IV: ANËTARËT E AMCHAM-IT

A & A Group
A & B Business Consulting
A Bi Esse
ABC Health Foundation
ABCCom
ACG-Advanced Construction Group
ACI Engineering
Adamb
Adriatic Ventures - ADI
Ak-Invest
Aksioner International Securities Brokerage
Alba Skela Construction
Albanian - American Enterprise Fund
Albanian Center for Economic Research
Albanian Duty Free Distribution
Albanian International School
Albanian Mobile Communications S.A. -AMC
Albanian-American Development Foundation
AlbAtlas
AlbGarden
Albtours "D"-VAS tour operatore
Aldkris
Alkan/Sh
Alpha Bank
Alumil - Albania
Ambra Srl.
American Noble Coffee
American Training Center
Amined
Andela - Woodrow Wilson School
ANDE-LM Agency
Anosis
Antea Cement
Antoneta Gjeçi
APIA Wealth Management Albania
Artinel
Auto Star Albania
Avanntive Consulting
AVON Cosmetics Albania
B & B Food Service
Bakery Adriatica
Balfin-Balkan Finance Investment Group
Bankers Petroleum Albania Ltd.
Bar-Gallery-Art Cubi
Bar-Restaurant "Shqiponja"
Bayer D.O.O. Tirana Representative Office
Bërdica
Bereqet
Beta
Bilanc
Bindi
Birra Korça
Boga & Associates
Bozgo
Bozo & Associates
British American Tobacco Albania
Brunes
Bukuria Shqiptare Beli
CCS
Century 21 Albania
CMB Albania
Co Casa
Coca-Cola Bottling Shqiperia
Coffee Club Albania
Communication Progress
Dajti Construxion
Dajti Ekspres
DDB Albania
Deloitte Albania
Deutsche Lufthansa' Albania Branch
Devoll Hydropower
DHL International Albania Ltd.
Dimapak
Dinamo
DM Consulting Services Albania
Easypay
Eco Mat
EGNATIA Group
EHW
Elledi
Embassy of the United States
Enrico-Marinelli
Enternal
Era 2000
Erbiron
Ermira Lulaj
Ernst & Young Albania
Europetrol Durrës Albania
Everest IE
Express Albania
Eyes Advertising
Farmatech
Fatjon Lami
Fatmir Kazazi
Fejzo
Financial Services Volunteer Corps
Financial Union Tirana - Western Union
First
Florifarma
Friends Distribucion
Fufarma
Fusha
Fushe Kruja Cement Factory
GAEA-Green Alternative Energy
GDQ International Christian School
Gender Alliance Development Center
German Albanian Logistics Agency (GALA)
GlaxoSmithKline Export Ltd.
Golden Eagle - Rogner Hotel Europapark
Grant Thornton

GSA
 Harry T. Fultz Foundation
 Hewlett Packard IT BV Albania Branch
 Hoffmann - La Roche
 ICTS Albania
 IDRA
 Ilia Kabuci
 InfoSoft Systems
 Instituti Jeta e Re
 Intech +
 International Commercial Bank
 Intersig Vienna Insurance Group
 Intesa Sanpaolo Bank
 Iris
 Jordil
 JT International Tirana
 Junior Achievement of Albania
 Jupiter Computer Systems Ltd.
 K.T & Associates
 Kalo & Associates
 Kantina e Pijeve Gj.K. Skënderbeu
 Kastrati Group
 KDF
 KESH
 Kika
 Konsort
 Korsel
 KPMG Albania
 Laura Pustina
 Lincoln Centers of Albania
 Llambi Karbunara
 Loloçi & Associates
 Marketing & Distribution, Albania
 Marlotex
 McCANN Tirana
 Melgushi
 Mermer Balliu
 Messer Albagaz
 Microsoft Albania
 Miell - Tirana
 Mifol Inerte
 MRDC
 Muça
 National Chamber of Private Judicial
 Execution
 NCH Advisors Inc.
 Net-SFS
 Nisatel
 NOA
 Optima Legal & Financial
 P.V.N. Colosseo
 Pelinku Jeans
 Philip Morris Albania
 Pianeta
 PolitOn Centre
 Porsche Albania
 Prespa 2000
 PricewaterhouseCoopers Audit
 Printec Albania (Cyprus) Limited
 Procredit Bank
 Professional & Business Women Association
 Rametal
 Real Estate "INF 93"
 Regional Development Agency, Korça
 Rejsi Farma
 Relikaj Ltd.
 Renova
 S & T Albania
 Salltik
 SHAFP Sigal Life Uniqa Group Austria
 Sheraton Tirana Hotel
 SIGAL Uniqa Group Austria
 Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group
 Small Business Association, Korça
 Sokol Arishta
 Starnet
 Stefani & Co
 Studio Mallkuçi & Sadushaj
 Taçi Oil International
 Tafaj "Z"
 Tashko Pustina - Attorneys
 TCN
 Tea Construction & Petrol
 Teknoxgroup Albania
 Tendence 3A
 Tetra Tech ARD
 Teuta Durrës
 Tirana Bank
 Tirana Business Park
 Tirana International Airport
 Tirana Leasing
 Tirez Exploration
 Tobacco Holdings Group
 Tona Co
 Tonucci & Partners Albania
 Transatlantic Albania Ltd
 Trema Engineering 2
 TriMed
 Turgut Ozal
 TUV Austria Albania Shpk & TUV Academy
 Ulysses Enterprises
 United Bank of Albania
 United Transport-UPS
 University of New York Tirana
 Valu Add Management Services
 Vasil Shandro
 Veneto Banka
 Vera Qerrushi
 Vodafone Albania
 Western Atlas International Inc.
 World Vision Albania
 Zaka & Kosta Attorneys at Law
 Zef Doçi
 Zhan 92
 ZICO

KONSORT

11 Vite Suksesi

në Teknologjinë e Informacionit
dhe Zhvillimit të Software-ve.

Konsulencë, Zhvillim Software, Sisteme IT

Për më shumë se 11 vjet **Konsort** ka ndërtuar sisteme IT që kanë rritur shitjet dhe përmirësuar shërbimet e klientëve tanë në Telekomunikacion, Sektorin Financiar, Energji, Shëndetsi, Administratën Publike, etj.

Shërbimet Tona

- ◆ Konsulencë IT
- ◆ Zhvillim Software-i
- ◆ Integrim Sistemesh
- ◆ Outsourcing
- ◆ Suport & Mirëmbajtje
- ◆ TrajnimeIT

Zgjidhjet Tona

- ◆ Business Intelligence
- ◆ Sisteme Raportimi
- ◆ Menaxhim Dokumentesh
- ◆ Sisteme Telekomit
- ◆ Sisteme Sigurie dhe Auditi
- ◆ Zgjidhje Virtualizimi

